



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 13.09.2023, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
3. Valon Pacolli, DEZH
4. Imri Semetishti, DPUMM
5. Rexhep Rexhepi, DBPZHR

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 18-të e KPF-së.

2. Propozim vendim mbi aprovimin e buxhetit 2024-2026
3. Raporti i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e Buxhetit për vitet 2024-2026.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për Monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës për periudhën 3 korrik 2022- 3 korrik 2023.
5. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunave në ZK Konjuh.
7. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW).
8. Propozim Vendimi për përcaktimin e festivalit “Mërgata Fest” si festivali tradicional i Komunës së Lipjanit.
9. Propozim Vendimi për përcaktimin e festivalit “Rinia Fest-Lipjan” si festivali tradicional i Komunës së Lipjanit.
10. Raporti Janar-Qershor 2023 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 18-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 18-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

II

Propozim vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit nga DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Raporti i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e Buxhetit për vitet 2024-2026.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se kjo pike a jeni pajtimit te shkoj direkt për kuvend.

Me te gjitha votat prezentë kaloi kjo pike.

IV

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për Monitorimin e zbatimin e Hartës Zonale të Komunës për periudhën 3 korrik 2022- 3 korrik 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, nga DUPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se unë e kam një pyetje a ka edhe ndonjë komune tjetër qe e qet këtë raport ne kuvend apo jemi komuna e vetme.

Imri Semetishti, tha se jemi komuna e vetme qe e dërgojmë ne kuvend këtë raport.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit nga DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunave në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit nga DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se me këtë ligjin e ri në secilin dhënë të pronës nga një komision është me të vërtetë shumë e mundimshme por edhe kanë përgjegjësi këta anëtar.

Daut Azemi, tha se ligji i ri ka shkaktua probleme pasi që me herët ka qene një komision i cili ka bere një përvojë të mire por ka pas edhe përgjegjësi

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

**Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief
Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW).**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit nga DBZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

**Propozim Vendimi për përcaktimin e festivalit “Mërgata Fest” si festivali
tradicional i Komunës së Lipjanit.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-LLugiqi, nga DKRS e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kam një propozim që ky festival të organizohet me një vend tjetër pasi që sheshi po është i vogël dhe nuk po i nxë dhe do të ishte mirë që të jete një lokacion me i madh. Po ashtu e kam edhe një vërejtje që kioskat që po vendosen në shesh gjatë këtij festivali po vendosen përball lokaleve të cilat janë në shesh dhe kjo është e pa drejtë.

Egzona Bytyqi, tha është mirë që në këtë vendim të përfshihet dhe propozimi im të cilin e kam dhënë edhe në kuvend për pritjen e mërgimtarëve nga kuvendi.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se është ide që me ka pëlqyer dhe mund ta bëjmë si kuvend se bashku këtë.

Anila Reqica Llugiqi, tha se me vendim nuk e kemi caktuar lokacion ndoshta do ta ndryshojmë në të ardhëm lokacionin do të shohim ndonjë ide me të mirë. Dhe çfarëdo ideje që ne vjen ne do të vendosim se bashku.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IX

Propozim Vendimi për përcaktimin e festivalit “Rinia Fest-Lipjan” si festivali tradicional i Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-LLugiqi, nga DKRS e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

X

Raporti Janar-Qershor 2023 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se a pajtoheni e kjo pike direkt te shkoj për kuvend.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:45

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi